



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.52-4/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Hajriz Hoti, dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim ZL.Anr.52-4/2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër vendimit të PZAP-it ZL.Anr.52/2025 të datës 24.09.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR kërkesa për rishikim ZL.Anr.52-4/2025 e datës 24.09.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, ZL.Anr.52/2025 datë 23.09.2025, me të cilin vendim i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 2,500.00 €uro (dy mijë e pesëqind €uro), dhe ka detyruar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

Paneli me vendimin ZL.Anr.52/2025 datë 23.09.2025, ka miratuar ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, dhe i ka shqiptuar dënimi më gjobë subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në lartësi prej 2,500.00 €uro (dy mijë e pesëqind €uro), dhe ka detyruar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Në PZAP-i, me datë 24.09.2025, Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit ZL.Anr.52/2025 të datës 23.09.2025, në të cilën kërkesë të subjektit Politik (LDK), pretendohet se videoja e përmendur në ankesën e paraqitur nga PDK, nuk përbën material zgjedhor dhe promovues, por një përmbledhje informuese mbi aktivitetet dhe angazhimet e përditshme të Kryetarit të Komunës së Prishtinës. Gjithashtu, gjatë videos në asnjë vend nuk është logo e partisë, numri apo ndonjë shenjë identifikuese e cila paraqet mos zbatim të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Tutje, ka theksuar se pjesët e cekura në ankesë janë shkëputur nga konteksti dhe paraqiten sikur material zgjedhor, ndërkohë që në fakt bëhet fjalë për komunikime standarde që Komuna shpërndan për të informuar publikun mbi projektet dhe aktivitetet e saj dhe për të qenë sa më transparente. Për më tepër publikimi i tillë nuk ka përdorur mjete financiare të ndonjë subjekti politik dhe nuk është realizuar me qëllime promovuese elektorale. Bazuar në këto, kanë kërkuar nga PZAP që të anulohet vendimin ZL.Anr.52/2025, të datës 23.09.2025 dhe që ankesa e subjektit PDK të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se;

-Kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit ZL.Anr.52/2025, të datës 23.09.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesës për rishqyrtim të datës 24.09.2025, për shqyrtimin e vendimit ZL.Anr.52/2025, të datës 23.09.2025, konstatohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se subjekti politik LDK nuk ka bashkangjitur asnjë provë kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht nuk ka arritur të dëshmojnë karte pretendimet e kërkesës. Për më tepër, e njëjta gjatë afatit kohor për përgjigje në ankesë, nuk i ka ofruar panelit asnjë përgjigje dhe nuk ka kundërshtuar pretendimet e ankesës. Kërkesa për rishikim të vendimit është parashtruar një ditë pas pranimit të vendimit, duke theksuar kundërshtimet e ankesës, pa prova mbështetëse. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejt, i ndërtuara mbi fakte, prova dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë dhe nga provat e reja të ofruara si dëshmi parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lart.

Në nenin 118 par.4 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Andaj, PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura, vendosi që kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga Subjekti Politik LDK të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 par. 4, dhe nenit 115 par. 1 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.52-4/2025, datë 25.09.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës.